

BEQIR META

HISTORIOGRAFIA GREKE PËR MARRËDHËNIET GREKO-SHQIPTARE*

Pretendimi se të gjithë të krishterët e Shqipërisë së Jugut janë grekë dhe, meqë ata përbëjnë shumicën e popullsisë, e tërë krahina duhej t'i jepej Greqisë. Ky ka qenë argumenti themelor i historiografisë dhe i propagandës greke gjatë 40 vjetëve të para të shekullit të kaluar. Në të vërtetë, statistikat zyrtare shqiptare dëshmojnë të kundërtën. Në krahinat e Korçës e të Gjirokastrës shqiptarët myslimanë ishin më të shumtë. Sipas regjistrimit të vitit 1930, popullsia e krahinave të Korçës e të Gjirokastrës ishte si më poshtë:

	Myslimanë	Ortodoksë
Korça	95.222	52.052
Gjirokastra	71.323	72.397
Totali	166.545	124.449

Por argumenti më i rëndësishëm që provonte karakterin shqiptar të këtyre krahinave nuk ishte vetëm sasia e popullsisë myslimane në to, por sidomos origjina e pastër shqiptare e shumicës dërrmuese të popullsisë ortodokse të këtyre krahinave.

Gjatë shekullit XIX dhe deri në Luftën I Botërore, popujt e të gjitha kombësive të Ballkanit, të cilët nga pikëpamja fetare i përkisnin Kishës Ortodokse Greke, ishte bërë zakon të merreshin si grekë. Kishte një konfuzion, disa herë i pandërgjegjshëm, disa herë i qëllimtë, midis feve e kombësive. Shqiptarët, duke qenë populli i fundit në Ballkan, që fitoi lirinë nga sundimi turk dhe që, për këtë arsye, arritën të fundit të formonin kishën e tyre ortodokse të pavarur, kanë vuajtur më shumë se çdo popull tjetër nga kjo anomali absurde, si dhe nga propaganda dinake e kishës greke.

Kombësia dhe ndërgjegjja e formuar kombëtare shqiptare e shumicës së popullsisë së krishterë të Shqipërisë së Jugut, janë provuar nga ngjarjet historike të shekullit XX. Pikësëpari, Korça ka qenë gjithmonë një vatër e lëvizjes dhe e kulturës kombëtare shqiptare. Të krishterët e Shqipërisë së Jugut, në shumicën dërrmuese të tyre, nuk u lidhën me kishën greke, por me Kishën

* Kumtesë e mbajtur në *Seminarin III Ndërkombëtar të Albanologjisë*, organizuar në Shkup, më 23-27 shtator 2009, nga Universiteti Shtetëror i Tetovës.

Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH), e cila u themelua, fillimisht, në SHBA në vitin 1908 dhe pastaj në Shqipëri në vitin 1922. Vullneti i palëkundur i shumicës së banorëve të krishterë të krahinave të Korçës dhe të Gjirokastrës, i vërtetuar nga një numër hetimesh ndërkombëtare, ka qenë inkuadrimi në shtetin shqiptar, gjë që përcaktoi, më në fund, përfshirjen e këtyre krahinave, si në vitin 1913, ashtu edhe pas Luftës I Botërore, brenda kufijve të Shqipërisë.

Një nga tezat themelore të historiografisë moderne greke është ajo se shteti grek e ka pranuar krijimin e shtetit të pavarur shqiptar natyrisht në territoret përtej Shqipërisë së Jugut të cilën edhe sot historianët grekë e konsiderojnë si tokë greke ose të paktën si një territor jo shqiptar. Por në të vërtetë ngjarjet e shumta historike, para dhe pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, provojnë të kundërtën. Duke u përpjekur me të gjitha mënyrat dhe mjetet që të aneksonte Shqipërinë e Jugut, shteti grek, qysh në fillim të shekullit ishte bërë një ndër pengesat serioze të rritjes dhe fuqizimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe krijimit të shtetit të pavarur shqiptar. Më 18 gusht të vitit 1912, ditën kur qeveria turke pranoi kërkesat e shqiptarëve për autonominë e katër vilajeteve shqiptare, Greqia mori iniciativën e krijimit të një Lidhjeje Ballkanike. Ajo u propozoi qeverive bullgare, serbe e malazeze themelimin e një aleance katërpalëshe, që do të kishte si synim “frenimin e pretendimeve shqiptare”¹ ose, me fjalë të tjera, copëtimin e trevave shqiptare. Në këtë mënyrë, ashtu si më parë, kur kishte penguar dhe kundërshtuar shtrirjen e kryengritjes shqiptare antiosmane në jug të Shkumbinit, Greqia po ndiqte një politikë armiqësore, kundërshtuese e sabotuese ndaj aspiratave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe krijimit të shtetit shqiptar në territoret shqiptare. Kjo politikë kishte në themel aneksimin e Shqipërisë së Jugut, e cila, jo vetëm që kishte një përbërje etnike të dallueshme shqiptare, por ishte edhe e qenësishme për ekzistencën e shtetit shqiptar.

Një nga tezat më të përhapura të historiografisë greke është ajo se Greqia nuk ka ndërhyrë në jetën politike të shtetit të ri shqiptar dhe se Shqipëria e Jugut ose Vorio-Epiri siç e quan ajo kishte një karakter grek dhe luftoi për autonomi apo për pavarësi kundër shtetit shqiptar. Si argument më thelbësor ajo ka referuar lëvizjen vorio-epirote dhe Protokollin e Korfuzit. Protokollin e Korfuzit i 17 majit 1914, të cilin, historiografia dhe diplomacia greke, për dekada të tëra, më vonë, do ta vlerësonin si një fryt të lëvizjes dhe të përpjekjeve fitimtare të “Vorio-Epirotëve” dhe si një provë të karakterit grek të Shqipërisë së Jugut, ishte thjesht një maskaradë politike. Përfaqësuesi britanik në KNK shkruante në atë kohë se “marrëveshja e Korfuzit nuk bazohej në asnjë

¹ Vasilis Kondis, *Greqia dhe Shqipëria në shekullin XX*, Selanik: 1997, f.44. (Autori i referohet një udhëzimi të Koromillasit për ambasadat greke në Sofje, Beograd dhe Cetinjë, Athinë, 18 gusht 1912).

të vërtetë dhe fundi i saj, domethënë – shporta e letrave, mua më dukej një gjë e sigurt”.

Terrori grek në Shqipërinë e Jugut, pati si rezultat zhvendosjen e një popullsie masive shqiptare të besimit mysliman e ortodoks dhe krijimin e 100.000 refugjatëve. Teza greke se gjoja “Lëvizja Vorio-Epirote” ishte produkt vetëm i popullsisë vendase, vuan edhe nga disa inkonsekuenca logjike. Ajo nuk mund të provohet nga burime dokumentare të paanshme dhe nuk ka bazë logjike, për arsye se komisionet ndërkombëtare, që kanë hetuar gjendjen në Shqipërinë e Jugut, kanë vërtetuar mbizotërimin e popullsisë shqiptare në rajon. Kështu është e vështirë të shpjegohet se si një pakicë greke ose grekomane arriti të thyente një popullsi vendase shumë më të madhe në numër dhe ta shtrëngonte atë të braktiste trojet e veta, pa një ndihmë të fuqishme nga jashtë.

Historiografia greke ka bërë shumë përpjekje të sforcuara për të provuar se qeveria greke qëndroi mënjanë dhe neutrale ndaj këtyre ngjarjeve. Por kjo tezë vuan nga fakti se askush nuk e verifikoi tërheqjen e ushtrive greke pas kërkesës që i drejtuan Greqisë Fuqitë e Mëdha. Për të verifikuar tërheqjen nuk kishte asnjë organizëm ndërkombëtar të paanshëm. Ndërsa pala shqiptare ngriti zërin duke thënë se trupat greke nuk ishin tërhequr nga Shqipëria e Jugut, por vetëm ishin shndërruar në “kompani të shenjta”. Sado tendenciozë, edhe disa historianë grekë nuk kanë mundur të mohojnë idenë se ushtria greke do të ndërhynte me armë, në rast se forcat shqiptare do të futeshin në rajon ose nëse atje do të ndodhnin incidente midis shqiptarëve dhe elementëve grekomanë², ose faktin tjetër se qeveria greke e ndoqi dhe e orientoi të gjithë procesin e tragji-komedisë së lëvizjes “Vorio-Epirote”³. Më vonë, në një studim të Forin Ofisit u arrit në konkluzionin se kjo lëvizje “po forcohej dhe nxitej nga qeveria greke dhe se “trupat greke duhej të ishin larguar nga “Epiri i Veriut” në fund të prillit të vitit 1914, por, në fakt, shumë prej tyre qëndruan atje për të shërbyer. Ata kryen masakra dhe djegie në afërsitë e Tepelenës, Korçës dhe në krahina të tjera”⁴.

Kur i është paraqitur rasti, Greqia ka tentuar dhe ka realizuar pushtimin ushtarak të Shqipërisë së Jugut, edhe pas vendimit të Konferencës së Londrës së vitit 1913. Kështu që teza greke se Greqia e ka kërkuar gjithmonë aneksimin e këtij territori vetëm në rrugë diplomatike, nuk i qëndron të vërtetës historike. Ushtria greke e ripushtoi Shqipërinë e Jugut në tetor të vitit 1914 dhe në mars të vitit 1916, Greqia shpalli me dekret mbretëror aneksimin e saj, madje, prej kësaj krahine u zgjodhën edhe deputetë për në parlamentin grek⁵. Por pas

² *Po aty*, f.67. (Autori i referohet një korrespondence të Ministrisë së Mbrojtjes së Greqisë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Athinë, 20 shkurt 1914).

³ *Po aty*, f.68-79.

⁴ Foreign Office (më tej: F.O.) 371/24868, Studim i Departamentit Kërkimor të F.O., 10 gusht 1944.

⁵ Ph.Philon, *The Question of Northern Epirus*, Washington: 1945, f.15.

protestave nga ana e Fuqive të Antantës, deputetëve “vorioepirotë” ua hoqën mandatet. Italia nuk e pranoi aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga Greqia në vitin 1916, dhe ushtritë e saj e pushtuan këtë territor, duke dëbuar grekët që andej.

Ndërkohë, në vitin 1916, Korça u pushtua prej trupave franceze. Gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore dhe gjatë zhvillimit të Konferencës së Paqes, kur forcat franceze ishin vendosur në krahinën e Korçës, ushtria greke i qëndroi gjithmonë si shpata e Demokleut kësaj krahine. Rreziku u shmang nga mençuria dhe vendosmëria e lëvizjes patriotike të popullsisë së zonës. Në këtë periudhë francezët patën rastin të njohin nga afër karakterin thjesht shqiptar të kësaj krahine, vullnetin e popullit të saj për t’u bashkuar me shtetin shqiptar, por edhe jehonën e krimeve që kishte kryer atje ushtria greke në vitet 1913-1915. Shefi i Sigurimit francez në Korçë, P.Tubert, i cili, ndonëse nuk ishte një përkrahës i aspiratave të shqiptarëve, i gjendur përballë këtij realiteti shqiptar, u shkruante organeve eprore: “Nëqoftëse gurët e vjetër të Panteonit, si dëshmitarë të pamohueshëm të një qytetërimit, tanimë të zhdukur përgjithmonë, janë për Athinën një paladium i paprekur, rrënimet e fundit të Tepelenës dhe të Leskovikut tregojnë se sa e rrezikshme është t’i lësh Greqisë dorë të lirë, nën pretekstin e mbrojtjes së të drejtave ... Dhuna dhe intoleranca, që kanë treguar grekët ndaj shqiptarëve, i kanë bashkuar këta të gjithë, myslimanë dhe të krishterë, në një urrejtje të përbashkët”. Do të ishte “një ironi e hidhur të duash të mbash nën zgjedhën greke, (qoftë edhe në formën e jashtëzakonshme), të gjithë ose një pjesë të popullit shqiptar”⁶. Konstatimet e francezëve mbi karakterin shqiptar të Korçës nuk ka mundur t’i mohojë edhe vetë historiografia greke, megjithëse ajo përpiket t’i paraqesë ndjenjat kombëtare shqiptare të popullsisë së kësaj treve në vitin 1920, si një transformim të ndjenjave greke që ajo kishte patur në vitet 1916-1918⁷. Por është shumë e vështirë të pranohet dhe të arsyetohet ky argument i ndryshimit të ndjenjave kombëtare, nga greke në shqiptare brenda dy vjetëve.

Pas Luftës I Botërore, çështja e aneksimin të Shqipërisë së Jugut u ngrit në Konferencën e Paqes nga Venizellosi, i cili u përpoq me të gjitha forcat të fitonte bekimin për realizimin e ambicieve territoriale greke në kurriz të Shqipërisë. Më 3 shkurt 1919, ai i kërkoi Konferencës aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga Greqia. Duke parë se elementët e kombësisë greke në këtë krahinë ishin një pakicë e vogël, ai u përpoq të injoroheshin elementet gjuhësore e racorë dhe, për përcaktimin e karakterit etnik të krahinës, të merrej për bazë vetëm ndërgjegjja kombëtare⁸. Për këtë qëllim, ai kërkoi edhe zhvillimin e një

⁶ Muin Çami, *Shqiptarët dhe francezët në Korçë, 1916-1920*, Tiranë: 1999, f.77. (Autori i referohet një raporti të P.Tyberit, të datës 21 dhjetor 1916).

⁷ V.Kondis, *vep. e përm.*, f.102.

⁸ *Po aty*, f.96; Eleftheros Venizelos, *Greece Before the Peace Congress*, New-York: 1919, f.2-3.

referendumi. Këtë pikëpamje e kanë bërë të vetën në atë kohë dhe më vonë edhe historianët grekë. Kjo praktikë u vinte për shtat interesave greke, për arsye se Greqia shpresonte ta kthente rezultatin e referendumit në favor të saj. Këto shpresa bazoheshin në një sërë përparësish, që kishte fituar në këtë kohë në Shqipërinë e Jugut. Ajo kishte një kohë të gjatë që kishte përqendruar të gjithë arsenalin e saj propagandistik, ekonomik e ushtarak dhe një potencial agjenturor të fuqishëm në këtë krahinë dhe po përfitonte nga mosfunksionimi i shtetit shqiptar në rrethanat e trazuara të pushtimit të Shqipërisë nga Fuqitë ndërluftuese. Zhvillimin e një referendumit në këtë kohë e pranuan edhe udhëheqësit shqiptarë, por këta kërkuan krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e tij dhe kryerjen e referendumit në të gjitha territoret shqiptare të kontestuara. Ata kërkuan që këto territore të pushtoheshin për 1-2 vjet nga ushtria amerikane dhe, në përfundim të kësaj periudhe, të organizohej një referendum nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Krejt e kundërta do të ndodhte më vonë, në vitin 1946, kur qeveria greke kundërshtoi një propozim të SHBA e të Britanisë së Madhe për të zhvilluar një referendum për përcaktimin e karakterit etnik të rajonit. Kjo për arsye se tashmë në rrethanat kur ajo nuk mund të ushtronte trysni politike, ushtarake apo ekonomike, ishte e sigurt se rezultati do të ishte në favor të shqiptarëve.

Në Komitetin për Çështjet Greke e Shqiptare që u krijua nga Konferenca e Paqes në shkurt të vitit 1919, pretendimet territoriale greke gjetën përkrahjen e plotë të Francës dhe të Anglisë, si dhe mbështetjen e pjesshme të SHBA, ndërsa Italia, fillimisht, u shpreh për ruajtjen e kufijve të vitit 1913 në trevat jugore të Shqipërisë, të cilat synonte t'i vinte nën protektoratin e saj. Për shkak të këtyre mosmarrëveshjeve, çështja e kufijve shqiptaro-grekë mbeti e hapur. Por politika italiane mori një kthesë të rrezikshme në verën e vitit 1919. Me qëllim që të manovronte më mirë dhe të kishte mundësi të përqendronte vëmendjen në “Çështjen e Adriatikut”, qeveria italiane, që erdhi në fuqi në qershor të vitit 1919, filloi bisedimet e drejtpërdrejta me qeverinë greke. Këto bisedime përfunduan me nënshkrimin, më 29 korrik 1919, të marrëveshjes së fshehtë Titoni-Venizellos, në bazë të së cilës Roma do të mbështeste në Konferencë kërkesën greke për aneksimin e Korçës dhe Gjirokastrës, ndërsa Athina do të përkrahte mandatin italian mbi Shqipërinë e cunuar dhe aneksimin e Vlorës nga Italia. Greqia, gjithashtu, pranonte t'i lëshonte Italisë për 50 vjet një pjesë të skelës së Sarandës dhe të ruante asnjësinë e Kanalit të Korfuzit. Kjo marrëveshje është dëshmia më e qartë se politika greke, e shtyrë nga ethet e saj shoviniste, e ka ndjellë dhe e ka thirrur vetë penetrimin e Italisë në Shqipëri dhe në Ballkan. Madje, këtë orientim Venizellosi e kishte përcaktuar që në vitin 1913, kur çështja shqiptare diskutohej nga Konferenca e Londrës. Në një intervistë dhënë gazetës “Secolo” të Milanos, më 1 dhjetor të vitit 1916, ai theksonte: “Mendoj se rivendikimet tona etnike në “Epirin e Veriut” nuk janë në asnjë mënyrë të papajtueshme me interesat jetike të Italisë,

të cilat e nxitin të marrë në zotërim hyrjen e Adriatikut. Ky zotërim për Italinë sigurohet me mbajtjen e Vlorës dhe të Ishullit të Sazanit. Përsa i përket Vlorës, qysh më 1913 e kisha siguruar markezimin di San Giuliano, se Greqia do ishte tejet e kënaqur me aneksimin e Vlorës nga Italia. Po kështu, nuk pata ëndërruar kurrë të nxjerr pengesa për marrjen e Ishullit të Sazanit...⁹. Pra, politika greke për arritjen e një marrëveshjeje me Italinë lidhur me ndarjen e zonave të influencës në Shqipëri, ka qenë konstante dhe marrëveshja Titoni-Venizellos nuk ishte një episod i veçantë. Në këtë mënyrë, teza greke, që është hedhur më vonë, se pretendimet greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut i ka përforcuar politika e shqiptarëve, e cila e ka tërhequr influencën italiane në Shqipëri, është thjesht një spekulim politik.

Pas periudhës së turbullt të viteve 1913-1920 dhe pas dështimit të shumë përpjekjeve të grekëve për ta pushtuar ushtarakisht Shqipërinë e Jugut, marrëveshja e parë ndërmjet të dyja palëve u nënshkrua në Kapshticë (afër Korçës) më 15 maj 1920. Neni 2 i kësaj marrëveshjeje përcaktonte se “shkollat dhe kishat greke do të funksionojnë lirisht në këtë territor”¹⁰. Protokollin e Kapshticës ishte një marrëveshjeje e përkohshme, sipas së cilës të dyja palët angazhoheshin të ruanin statukuonë në Shqipërinë e Jugut, deri në një vendim definitiv të Fuqive të Mëdha për fatin e krahinës. Kjo marrëveshjeje u arrit nën presionin dhe rrezikun e madh të një sulmi të ushtrive greke, në momentet kur trupat franceze po largoheshin nga Korça. Por, në të njëjtën kohë, më 10 gusht 1920, Greqia nënshkroi me Fuqitë e Mëdha një Traktat, i cili, në nenin 3 të tij përmbante edhe këtë paragraf: “Greqia njeh si qytetarë grekë me të gjitha të drejtat dhe pa asnjë formalitet tjetër, të gjithë qytetarët bullgarë dhe turq (ose shqiptarë), të cilët, ditën që ky traktat hyn në fuqi, jetojnë në territoret e transferuara Greqisë pas 1 janarit të vitit 1913”¹¹. Historianët grekë e kanë keqinterpretuar këtë marrëveshjeje duke injoruar karakterin e përkohshëm të saj dhe ashtu si politikanët grekë e kanë akuzuar Shqipërinë se e ka shkelur këtë marrëveshjeje. Nga ana tjetër ata mohojnë tërësisht angazhimin ndërkombëtar që kishte shteti grek për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të minoritetit shqiptar në Greqi. Deklarata që bëri qeveria shqiptare në vitin 1921 mbi minoritetet, është quajtur shpesh nga politikanët dhe historianët grekë si një zotim për të ruajtur “karakterin grek të krahinave të Gjirokastrës dhe Korçës”. Në të vërtetë, qeveria shqiptare nuk dha kurrë dhe as që mund të jepte një premtim të tillë, në atë kohë kur Konferenca e Ambasadorëve ishte duke rishikuar këtë problem, dhe për arsyen e fortë se popullsia e tyre ishte në masën dërrmuese me kombësi shqiptare. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare njohu dhe

⁹ V.Kondis, *vep. e përm.*, f.85.

¹⁰ Protokollin e Kapshticës, teksti i plotë është botuar nga B.P.Papadakis, *Histoire Diplomatique de la Question Nord-Epirote*, Athens: 1958, f.59-62.

¹¹ *Po aty*, f.63.

respektoi të drejtën e pakicës greke që të përdorte lirisht gjuhën greke dhe ta mësonte atë në shkolla publike, të cilat i mbante dhe i financonte shteti shqiptar.

Pas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 9 nëntorit 1921, Greqia vazhdoi të ushtronte presion mbi shtetin shqiptar. Ajo bëri shumë akuza për keqtrajtimin e popullsisë së krishterë dhe të minoritetit grek. Këto argumente kanë qarkulluar gjerësisht dhe vijojnë të ekzistojnë në historiografinë greke e cila në shumicën e rasteve bën një ngatërrim të qëllimtë të detyrimeve dhe politikave që ka ndjekur shteti shqiptar ndaj minoritetit grekofon dhe procesit të afirmimit e konsolidimit të institucioneve dhe ndërgjegjes kombëtare të popullsisë ortodokse shqiptare. Që t'i jepej fund një gjendjeje të tillë, qeveria shqiptare i kërkoi Lidhjes së Kombeve të dërgonte një komision hetimor. Ky arriti në Shqipëri në fillim të vitit 1922 dhe përbëhej nga ekspertë të Lidhjes së Kombeve. E kryesonte profesori suedez Senderholm. Raporti i këtij komisioni, që iu paraqit Këshillit të Lidhjes së Kombeve më 12 maj 1922¹², është ndofta dokumenti më me rëndësi në historinë e marrëdhënieve greko-shqiptare dhe përbën, pa dyshim, një bazë serioze për studimin e kësaj çështjeje. Pas hetimeve që bëri në Shqipëri, Komisioni i Lidhjes së Kombeve arriti në dy përfundime të rëndësishme: 1- “Nuk ka asnjë dyshim se shumica e madhe e popullsisë së krishterë është në favor të regjimit të sotëm dhe përbën një faktor me rëndësi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. 2- “Komisioni e gjeti të drejtë dhe me vend vendimin e Fuqive që ia atribuoi të ashtuquajturin “Epir të Veriut” Shqipërisë”. Ai e rirforcoi bindjen se “ekzistenca e një Shqipërie të pavarur është nevojë për paqen e asaj pjese të Evropës dhe se një Shqipëri e pavarur, është e mundur vetëm në qoftë se përfshin krahinat e Korçës dhe të Gjirokastrës”.

Në raportin e tij Komisioni dha në një formë të përmbledhur arsyet historike mbi të cilat ishin bazuar përfundimet e tij në favor të përkatësisë etnike shqiptare të këtyre dy krahinave. Në të pohohej se “ndonëse popullsia e Shqipërisë së Jugut është krejt shqiptare, - ekziston një grup i vogël grekofilësh, që është një mbeturinë e ditëve kur Shqipëria ishte nën zgjedhën turke, dhe shqiptarët e krishterë shikonin te Greqia një çlirimtar të mundshëm dhe një vend në të cilin ata, si të krishterë, nuk do të merreshin si njerëz inferiorë. Ajo pjesë e molepsur me propagandën greke, e cila kishte frikë se propozimi për të vendosur një Kishë Shqiptare Autoqefale do të shkaktonte një shkëputje të hapët nga Patriarkana dhe, përveç kësaj, disa tregtarë, që kanë interes të mbajnë marrëdhënie të mira me Greqinë, përbëjnë minoritetin grekofil.” Në këtë raport pohohej se “Korça, në të cilën ekzistonte një minoritet “helenofil”, ishte substancialisht një qytet shqiptar”; se “ndjenjat helenofile të shumicës së popullsisë ortodokse të Shqipërisë së Jugut nuk duhet të merren si nacionalizëm grek” dhe “ndjenjat e popullsisë së krishterë të Shqipërisë së Jugut për Greqinë nuk janë ata të një irredenti, por ndjenja që ushqehen kundrejt një vendi që ka

¹² *League of National Journal*, viti III, nr.6, f.575.

qenë burimi i kulturës së tyre dhe armiku i regjimit të urreyer otoman”. Edhe në të gjitha raportet e vëzhguesve ndërkombëtarë që kanë qenë në Shqipëri gjatë shekullit XX është nënvizuar trajtimi korrekt, liberal dhe dashamirës i minoritetit grek nga shteti shqiptar.

Një nga problemet e shumta që përballoi shteti shqiptar pas Luftës I Botërore ishte edhe ai i shkollave greke, që funksiononin në Shqipërinë e Jugut. Ka më se 80 vjet që nga historiografia dhe propaganda greke i është servitur opinionit grek dhe të huaj të besojë se ka pasur një të drejtë, pothuajse hyjnore, që t’i kishte këto pararoja të helenizmit në Shqipëri dhe se vendimi i Shqipërisë për mbylljen e tyre ishte vetëm një akt barbar që përlyente tempullin e qytetërimit. Në të vërtetë, shkollat greke ishin një rudiment i periudhës së robërisë otomane. Gjatë sundimit osman shqiptarët u ndaluan të çelnin shkollat e tyre, u ndaluan edhe botimet e çdo natyre në gjuhën shqipe. Në këto rrethana ata, ose duhej të venin në shkolla të huaja, ose të mbeteshin analfabetë. *Libra* dhe revista të ndryshme në gjuhën shqipe botoheshin fshehurazi nga patriotët entuziastë shqiptarë dhe familja u bë qendra e mësimin në gjuhën amtare. Por të tilla aktivitete konsideroheshin si veprime kriminale nga ligjet e Perandorisë. Kështu, në Shqipërinë e Jugut gjithë fusha edukative ishte monopol i shkollave greke, të cilat ishin, gjithashtu, qendra të propagandës politike e fetare dhe si, të tilla, gëzonin përkrahjen e Patrikut të Stambollit, të Mitropolitit Ortodoks të Athinës dhe të Lëvizjes Greke të asaj kohe. Qëllimi i largët i kësaj propagande ishte realizimi i “Idesë së Madhe” “për bashkimin e copërave të shpërndara të helenizmit” në Mbretërinë Greke. Inteligjencia shqiptare, që ishte e detyruar të frekuentonte këto shkolla, për të mos mbetur prapa kombeve të tjera të Perandorisë Osmane, përgjithësisht i dinte të gjitha këto, ashtu siç po konstatonte me hidhërim se grekët dhe turqit ishin në të njëjtat pozita në përpjekjet për të shtypur çdo shfaqje të ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

Duke pasur parasysh se nacionalizmi shqiptar ka qenë gjithnjë i shtypur nën zgjedhën osmane dhe se Greqia i kishte në dorë të gjitha mundësitë për të helenizuar popullsinë nëpërmjet kishës ortodokse dhe shkollave greke, për shumë politikanë dhe historianë të huaj ka qenë impresionues përparimi i dukshëm që bëri nacionalizmi shqiptar në fundin e shekullit XIX dhe në dy dekadat e para të shekullit XX. Në të tilla kondita, të krijuara artificialisht, as shkolla dhe as feja nuk mund të merren si kritere përcaktuese të përkatësisë kombëtare. Ortodoksët shqiptarë nuk mund të liheshin më, si në kohën e Turqisë, nën ndikimin e shkollës dhe të kishës greke, e cila para vitit 1912 kishte qenë zgjidhja e vetme dhe e keqja më e vogël. Që të përparonte, kombi shqiptar duhej të krijonte sistemin e vet arsimor dhe kishën e tij kombëtare.

Ky proces i zhvillimit kombëtar nuk përbën asnjë argument për tezën e historiografisë greke se ai ishte një program sistematik i shkombëtarizimit të

elementit grek¹³, për arsyen e thjeshtë dhe thelbësore se bartësit e këtij arsimit ishin shqiptarë ortodoksë dhe jo grekë. Vendimi i qeverisë shqiptare për të zëvendësuar shkollat greke në Shqipërinë e Jugut me shkollat shqipe nuk ishte as i paligjshëm dhe as arbitrar. Ai ishte një rrjedhojë e drejtpërdrejtë e vendimit final të caktimit të kufijve shqiptaro-greke prej Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921. Popullsia shqiptare në Shqipërinë e Jugut kishte të drejtat e padiskutueshme legjitime të shkollonte brezin e ri të saj në gjuhën amtare.

Gjatë periudhës së paraluftës, një problem, që është diskutuar shumë, ka qenë madhësia dhe shtrirja e minoritetit grek në Shqipëri. Më 1923 Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve konkludoi se numri i popullsisë greqishtfolëse në Shqipërinë e Jugut arrinte në 35.000 – 40.000 persona. Në vitin 1934 qeveria shqiptare deklaronte se numri i tyre ishte 37.270 vetë, kurse qeveria dhe historiografia greke vlerësonte se numri i tyre duhej të ishte 45.000 - 50.000 vetë¹⁴.

Historiografia greke ka mbrojtur disa teza spekulative se gjoja A.Zogu ushtroi një politikë të egër shfarosjeje kundër kristianëve ortodoksë¹⁵ dhe se të krishterët e Jugut kishin proporcionalisht një influencë më të vogël në çështjet shtetërore se sa myslimanët dhe katolikët. Madje, për këtë ata i referohen edhe raportit të lartpërmendur të M.Sederholmit¹⁶. Por për këto pretendime nuk mund të gjendet qoftë dhe një fakt i dokumentuar që t'i provojë.

Përpyekjet për identitetin kombëtar të shqiptarëve ortodoksë, gjatë sundimit osman, kishin çuar në krijimin e kishës shqiptare në SHBA, në vitin 1908. Atje ishte kolonia më e madhe shqiptare jashtë vendit, e përbërë kryesisht nga banorë të Shqipërisë së Jugut. Krijimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare në SHBA, ishte dëshmia më e qartë e vullnetit të ortodoksëve shqiptarë për të qenë të pavarur në çështjet kishtarë. Themelimi i KOASH në Amerikë, në këtë vend të lirë e asnjans, është një argument i mjaftueshëm për të rrëzuar pretendimet e historiografisë greke se krijimi i KOASH në Shqipëri ishte një puç kishtar, i bërë nën presionin e shtetit shqiptar, i cili gjoja kishte shkaktuar indinjatën e të krishterëve të Shqipërisë¹⁷.

Pas shpalljes së Pavarësisë, për arsye të ndryshme, nuk u krijuan dot kushtet e favorshme për krijimin menjëherë të një kisha të pavarur brenda në Shqipëri. Pengesat më të mëdha ishin Luftërat Ballkanike dhe fillimi pas tyre, i Luftës I Botërore. Gjatë kësaj periudhe, kleri i lartë grek u diskreditua mjaft në sytë e besimtarëve ortodoksë shqiptarë. Petkun e njerëzve të zotit ata e zëvendësuan me atë të politikanit aktiv dhe agresiv. Kështu, peshkopi i

¹³ V.Kondis, *vep. e për.*, f.122.

¹⁴ *Po aty*, f.108-109.

¹⁵ Panayotis Pipinelis, *Europe and the Albanian Question* (botimi i dytë), Çikago: 1963, f.78.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ V.Kondis, *vep. e për.*, f.125.

Durrësit, Jakovos, ishte kundërshtari i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. “Dhespoti i Durrësit përdor çdo intrigë si e si t’i krijojë telashe qeverisë së sotme”, shkruante në vitin 1913 Aqif Pashë Elbasani¹⁸. Më vonë, Jakovi u bë njëri nga përkrahësit e rebelimit antikombëtar në Shqipërinë e Mesme, duke patur si qëllim gjithmonë destabilizimin e vendit dhe, në të njëjtën kohë, përkrahu komplotin grek për shpalljen e “autonomisë së Epirit të Veriut”¹⁹. Peshkopët e Gjirokastrës dhe të Korçës bënë përpjekje për t’i shtyrë besimtarët t’i dërgonin peticione Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913, në të cilat kërkohej që këto treva t’i aneksoheshin Greqisë. Ata luajtën një rol të veçantë në organizimin e njësisë të armatosura, të ashtuquajtura “Batalione të shenjta” në vitin 1913. Një fakt tjetër komprometues për rolin politik dhe antishqiptar të këtyre mitropoliteve ishte përfshirja e tyre, në shkurt të vitit 1914, në përbërjen e qeverisë së J. Zografosit, e cila shpalli krijimin e të ashtuquajturit “Shtet Autonom i Epirit të Veriut”²⁰. Këta klerikë janë ndër përgjegjësit kryesorë të tragjedisë së madhe që pësoi Shqipëria e Jugut si rezultat i krimeve dhe masakrave greke. Ata u bënë kështu ndër shkaktarët e armiqësisë midis dy popujve, dhe nxitësit e një lufte vëllavrasëse, madje, edhe midis vetë shqiptarëve ortodoksë²¹. Edhe historiografia greke ka sjellë mjaft dokumente nga arkivat greke, të cilat provojnë bashkëpunimin e klerikëve të lartë grekë me qeverinë e Greqisë për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Këto burime, midis të tjerash, pohojnë se Mitropoliti Jakovos ishte informatori dhe këshilltari kryesor i qeverisë greke, në përgatitjet që bënte kjo për pushtimin e Korçës pas largimit të trupave franceze nga krahina²².

Në qershor të vitit 1923, qeveria shqiptare miratoi Ligjin e Komuniteteve Fetare, të cilin ia komunikoi Lidhjes së Kombeve. Ligji u analizua dhe u vlerësua nga reporteri i Këshillit të Lidhjes dhe nga Seksioni i Minoriteteve, të cilët arritën në konkluzionin se ligji i kënaqte plotësisht kërkesat e Lidhjes së Kombeve²³. Shpallja e Kishës Autoqefale në Berat, krijimi i sinodit dhe hartimi

¹⁸ Edit Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë: 1944, f.239, 256.

¹⁹ Muin Çami, “Kleri i lartë ortodoks në Shqipëri dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1912-1921”, botim i Akademisë së Shkencave dhe i Institutit të Historisë: *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, Tiranë, 1993, f.44.

²⁰ K.Skënderis, *O Vorioepereitikos Agon (1914)*, Athenai: 1930, f.46; Vasilis Kondis, *Greece and Albania (1908-1914)*, Thesaloniki: 1976, f.124-125.

²¹ M.Çami, *Kleri i lartë ortodoks në Shqipëri...*, f.46.

²² V.Kondis, *Greqia dhe Shqipëria...*, f.106. (Autori i referohet dokumenteve të Arkivit të MPJ të Greqisë, viti 1920, dos.A/5, Informacion i mitropolitit Jakov për MPJ të Greqisë, transmetuar me ndërmjetësinë e prefektit të Follorinës, Follorinë, 25 maj 1920).

²³ Dhimitër Berati, *Qëllimet dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve : botuar prej sekretarijs së Lidhjes së Kombeve*, Tiranë : Mbrothësia e Kristo Luarasit, 1931, f.20.

i statutit të saj më 1929, u bazua në parimin e njohur dhe të pranuar në mbarë ortodoksinë: “kishë e lirë në shtet të lirë.”

Krijimi i KOASH nuk u mirëprit nga politika dhe kisha greke. Ndaj kongresit u bënë shumë akuza, duke e cilësuar atë si antikanonik. Këtyre akuzave u bën jehonë edhe sot historiografia greke²⁴. Akti i njohjes së KOASH nga Patriarkana Ikumenike kaloi përmes një procesi të vështirë, që zgjati 7 vjet.

Historiografia greke, duke u vënë në mbrojtje të politikave të spastrimit etnik të shqiptarëve në Greqi, ka pretenduar vazhdimisht se në momentin e shkëmbimit të detyrueshëm të popullsisë greko-turke, ku shteti grek dëboi shumë shqiptarë, ishte i vështirë të bëhej dallimi midis shqiptarëve dhe turqve pasi shqiptarët e deklarorin veten si turq. Ky është një spekulim pasi dihet botërisht se në Çamëri nuk ka pasur asnjëherë turq por shumica e popullsisë ka qenë shqiptare e besimit mysliman dhe ortodoks. Kjo është vërtetuar nga gjithë historianët e huaj seriozë dhe e njohur botërisht. Historiografia greke ka heshtur dhe është përpjekur të fshehtë presionin policor, administrativ, ekonomik dhe propagandistik që bëri shteti grek për ta dëbuar këtë popullsi nga vatrat e veta.

Një pjesë e mirë e historiografisë greke të pasluftës, si edhe diplomacia greke gjatë periudhës së luftës së ftohtë, por edhe sot²⁵, kanë mbrojtur tezën absurde se populli çam (an bloc) ishte bashkëpunëtor i nazistëve dhe i fashistëve dhe u largua bashkë me ta për në Shqipëri në fund të luftës. Por si është e vërteta? Është rasti të pohohet se në luftën antifashiste, nga popullsia shqiptare e Çamërisë u përfshinë në formacionet luftarake shqiptare dhe greke mbi 1.000 luftëtarë, pa llogaritur qindra të tjerë që punonin në terren. Vetëm në radhët e ELAS-it dhanë jetën 68 partizanë çamë.²⁶

Ka pasur vazhdimisht tendenca të qarta të historiografisë greke për të injoruar dhe ç’vleftësuar luftën antifashiste të popullit shqiptar. Kjo historiografi ka shkuar në një vijë me politikën nacionaliste të qeverisë greke në ekzil të periudhës së luftës. Përpjekjet e saj për të diskredituar Lëvizjen Antifashiste Shqiptare, si një lëvizje me tendenca shoviniste, qeveria greke në emigracion i shtriu në drejtim të Londrës dhe Uashingtonit. Në maj të vitit 1943, ambasada mbretërore e Greqisë në Uashington, në një memorandum drejtuar Departamentit të Shtetit, vinte në dukje se “informacionet përfundimtare tregojnë se të ashtuquajturit patriotë shqiptarë po shpërthejnë një fushatë terrori kundër popullsisë greke të “Epirit të Veriut”. Dhuna po ushtrohet

²⁴ Apostolos A.Glavinas, *I Orthodoxosi Aftokefali Eklisia tis Alvanias*. (Defteri eklosi) (Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë), Thessaloniki (Selanik): 1989.

²⁵ Fjala e ministrit të Punëve të Jashtme të Greqisë, Karolos Papulias, në takimim me ministrin e Jashtëm të Shqipërisë Serreqi, në Zyrih, më 3 maj të vitit 1994; Replikë e ambasadorit grek në Asamblenë e Përgjithshme të OKB, 5 tetor 1994.

²⁶ *Arkivi i Shoqërisë Patriotike Atdhetare “Çamëria”*, dos. 6 (Cituar sipas kumtesës së H. Mingës, “Ndihma e çamëve në Luftën Antifashiste”).

në forma të ndryshme, me qëllim që të detyrohen grekët të ndryshojnë ndjenjat e tyre kombëtare²⁷. Më tej, administratës amerikane i paraqiteshin po ato argumente dhe i bëheshin po ato kërkesa, që i ishin bërë Londrës disa ditë më parë.

Falsitetin e pretendimeve greke për persekutimin e minoritetit grek e vërtetuan, pikësëpari, burimet britanike dhe amerikane. Gjithashtu, edhe më vonë nuk ka qenë e mundur të gjenden dokumente shqiptare, greke, italiane ose gjermane që ta provojnë këtë pretendim. Prandaj është për t'u çuditur se si edhe sot historiografia greke, megjithëse nuk mund të japë referenca konkrete e serioze, pranon si të vërteta trillet propagandistike të qeverisë greke të asaj kohe dhe ka mbrojtur pikëpamjen se, gjatë luftës, "grekët u gjendën midis dy zjarresh: përndiqeshin nga bashkëpunëtorët e italianëve dhe të gjermanëve dhe nga komunistët..."²⁸.

Pas përfundimit të luftës qeveria shqiptare e kontrolloi me kujdes minoritetin. Edhe në këtë zonë ajo e shtriu goditjen e kundërshtarëve të saj politikë, por represioni ishte krejtësisht i natyrës klasore dhe ideologjike. Ai ishte homogjen në raport me intensitetin dhe me natyrën e represionit në pjesët e tjera të vendit dhe nuk kishte asnjë motiv apo ngjyrë nacionaliste. Këtë gjë e kanë vënë në dukje qartësisht edhe misionet amerikane e britanike në Shqipëri, të cilat e kanë kontrolluar dhe vëzhguar me kujdes situatën. Këto argumente në i kemi paraqitur më lart, por këtu vlen të theksohet se edhe historianë grekë, e kanë pranuar natyrën jo nacionaliste të politikës së qeverisë shqiptare kundrejt minoritetit grek. Studiuesi grek Evangjelos Kofos shkruan se "pas përfundimit të luftës, grekët që nuk hoqën dorë nga aspiratat e tyre – kryesisht nga rikthimi i "Epirit të Veriut" Greqisë, iu nënshtruan masave shtypëse të padurueshme dhe u arratisën në Greqi. Nga ana tjetër grekëve që ndihmuan komunistët shqiptarë për të thyer rivalët e tyre iu bë një trajtim liberal në vijën e doktrinës leniniste mbi minoritetet²⁹. Represioni dhe goditja e regjimit në minoritet ishte e kufizuar dhe e drejtuar vetëm ndaj një pakice elementesh ekstremistë, që propagandonin ose punonin për aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga Greqia. Ndërsa shumica e minoritetit nuk e mbështeste politikën aneksioniste greke kundrejt Shqipërisë, gjë që e vinin në dukje edhe misionet aleate në Shqipëri. Lidhur me motivet e këtij qëndrimi bashkëpunues të shumicës së minoritetit me regjimin komunist, një shpjegim interesant ka dhënë E.Kofos, i cili shkruante: "fatkeqësisht, duke shpresuar se aspiratave të tyre nacionaliste mund t'u shërbehej nën një regjim

²⁷ *The Greek Minority in Albania - A Documentary Record (1921-1993)*, botuar nga Basil Kondis, Eleftheria Manda, Thessaloniki: 1994, f.112, Memorandum i Ambasadës Mbretërore Greke në SHBA, për Departamentin e Shtetit; NADS, 767,75/20, Uashington, 21 maj 1943.

²⁸ V.Kondis, *Greqia dhe Shqipëria ...*, f.127.

²⁹ Evangjelos Kofos, "Balkan Minorities under Communist Regimes", në *Balkan Studies*, vol.2, nr.1, Thessaloniki: 1961, f.42.

komunist, shumë grekë, pjestar të minoritet grek, u bashkuan me shqiptarët për të promovuar komunizmin në vend³⁰. Nga ana tjetër kjo gatishmëri u prit mirë edhe nga udhëheqja komuniste shqiptare e cila, në dallim nga homologët e saj në rajon, që ishin të orientuar nga politikat nacionaliste, ndiqte një vijë konsekuente internacionaliste në të gjitha problemet politike të brendshme dhe të jashtme. Këtë qëndrim E.Hoxhës ia rekomandoi edhe Molotovi në kohën e zhvillimit të Konferencës së Paqes në Paris. Ai porositi udhëheqjen shqiptare që të punonte për ta mbajtur minoritetin të bashkuar me qeverinë komuniste³¹.

Pleksja më e dukshme dhe flagrante e historiografisë dhe politikës greke dhe e karakterit tendencioz e aspak shkencor të kësaj historiografie është tipizuar në veprën e historianit dhe politikanit të njohur grek Panajotis Pippinelis. Ai për të realizuar aspiratat aneksioniste greke ka vënë në përdorim kulturën e tij të thellë si historian dhe e ka paraqitur historinë e shtetit shqiptar dhe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në një mënyrë të tillë tendencioze vetëm e vetëm për t'i shërbyer aspiratave aneksioniste greke. Në një pamflet historiko-politik që ai botoi në vitin 1949, në kulmin e Luftës së Ftohtë jepte pa ndrojtje këto opsione dhe argumente për fatin e Shqipërisë³².

1- *Propozimi ose varianti i parë*: - Copëtimi i Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë ose midis Greqisë, Jugosllavisë dhe Italisë. Ky ishte një plan i vjetër, i cili ishte diskutuar vazhdimisht në të kaluarën dhe përbënte një subjekt të rëndësishëm të akteve ndërkombëtare midis Serbisë e Greqisë, në vitin 1913, dhe midis Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë në vitin 1919, por që nuk kishte pasur sukses. Pippinelis e vlerësoi këtë variant si mënyrën “më të natyrshme dhe radikale” të zgjidhjes së çështjes shqiptare ose, siç shprehej ai, “të likuidimit të burimit të turbullirave” të së kaluarës në Ballkan. Planet dhe marrëveshjet e mëparshme për copëtimin e Shqipërisë, në të cilat drejtpërsëdrejti ose tërthorazi ishte përfshirë edhe Greqia, Pippinelis i quante të justifikueshme në rrethanat e atëhershme, kur “shteti shqiptar nuk ishte pranuar akoma nga opinioni publik si një entitet i qëndrueshëm dhe kushdo do ta merrte copëtimin e Shqipërisë si një garanci që ky vend të mos zhytej në konfliktet e brendshme dhe në vështirësitë e tij ekonomike. Megjithëse injoronte realitetin historik të periudhës para Luftës II Botërore, i cili kishte dëshmuar në mënyrë të qartë se, me gjithë vështirësitë e brendshme dhe presionin e jashtëm, shteti shqiptar arriti jo vetëm të mbijetonte, por edhe të konsolidohej, Pippinelis detyrohej të pranonte se pas Luftës II Botërore ishte bërë i vështirë dhe i pamundur një copëtim i Shqipërisë. Ndonëse e konsideronte jetën e pavarur

³⁰ *Po aty*, f.32.

³¹ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme*, viti 1946, dos.10. Telegram i E. Hoxhës për K.Xoxen, Paris, 24 gusht 1946.

³² John T. Malakasses, “The American Position 1946-1949”, on *Greeces Claims to Southern Albania*, Janina: 1984, f. 47-60.

politike të shtetit shqiptar “vetëm një emërtim”, ideatori i diplomacisë greke trembej se copëtimi i Shqipërisë do të binte ndesh vendosmërisht me “ndjenjat e opinionit ndërkombëtar, i cili do ta shihte si një akt agresioni nga ana e Greqisë dhe Jugosllavisë”. Por ky nuk ishte shqetësimi i vetëm. Aneksimi i gjithë territorit në jug të Shkumbinit, i cili, sipas zëvendës ministrit të Jashtëm grek, banohej “nga një popullsi e madhe heterogjene e njohur mirë për shpirtin e saj të pavarur”, do t’i komplikonte më tej problemet e brendshme të Greqisë dhe nuk do të çonte në stabilizimin e situatës. Në të vërtetë, këto konkluzione nuk ishin të sinqerta. Greqia, jo më larg se Konferenca e Paqes e vitit 1946, kishte kërkuar ndarjen e Shqipërisë midis saj dhe Jugosllavisë, por pa sukses. Diplomacia greke, duke ndeshur në kundërshtimin e vendosur të Fuqive të Mëdha ndaj projekteve të saj për copëtimin e Shqipërisë, po përpiquej të adaptonte një qëndrim “më të butë”, të sipërfaqshëm, në pajtim me frymën e re të politikës perëndimore pas Luftës II Botërore, për të cilin mendonte se do t’i sillte përfitime më të mëdha dhe më të sigurta.

Varianti i dytë ishte administrimi i Shqipërisë nga një organizëm ndërkombëtar ose nga një fuqi e pa interesuar. Por këtë zgjidhje, Pippinelis e quante të mundshme vetëm teorikisht dhe vetëm në qoftë se disa nga Fuqitë e Mëdha do të kishin vullnetin që, për një periudhë të gjatë disaveqare, të mbulonin deficitet e një “ekonomie tipike të falimentuar” dhe të merrnin përgjegjësinë politike për drejtimin e pavarësisë së Shqipërisë. Ndërsa, praktikisht, ai e vlerësonte këtë protektorat ndërkombëtar, mbi Shqipërinë të porealizueshëm, pasi organizmi kolektiv ndërkombëtar, që do ta ushtronte atë, do të ndeshte vështirësi në zbatimin e një politike të përbashkët. Në të vërtetë, arsyeja kryesore pse ai nuk e pëlqente këtë zgjidhje ishte se, ekzistenca e një shteti shqiptar në Ballkan binte në kundërshtim me objektivat e politikës greke dhe asaj jugosllave. Pippinelis shprehej se në këtë mënyrë nuk do t’i jepej zgjidhje çështjes kryesore të marrëdhënieve midis Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Greqisë e Jugosllavisë, nga ana tjetër, dhe do të konservohej “një problem, i cili, në analizë të fundit, ishte vital njësoj për këto shtete, ashtu siç ishte për vetë Shqipërinë”. Pra, ekzistencën e shtetit shqiptar ai e konsideronte një fatkeqësi për të gjithë, madje, edhe për vetë Shqipërinë. Duke u përpjekur që ta pasuronte me argumente të tjerë këtë tezë absurde, Pippinelis shtonte se “në fund të fundit, kjo zgjidhje do të sanksiononte përfundimisht ekzistencën e një entiteti politik në Ballkan, duke shtuar një shtet shumë të vogël në organizmin politik dhe ekonomik të Evropës, duke vendosur kufij të tjerë ekonomikë, administrativë dhe kulturorë në një sipërfaqe evropiane, ku “ballkanizimi”, tashmë, kishte shkuar shumë larg”. Pra, ai përjashtonte çdo mundësi të qytetërimit, të zhvillimit dhe të evropianizimit të Shqipërisë, gjoja për arsye se “ballkanizimi” i saj kishte shkuar shumë thellë. Këtu janë shfaqur qartë konceptet politike shoviniste dhe paragjykimet raciste të politikës greke të

kohës të cilat nga ana tjetër kanë qënë në thelbin e argumenteve të historiografisë greke.

Varianti i tretë, që sipas historianit të njohur dhe zëvendësministrit të jashtëm grek konsiderohej zgjidhja më racionale, ishte bashkimi i Shqipërisë me një nga vendet fqinje dhe pikërisht me Greqinë. Në fillim ai argumentonte pamundësinë e krijimit të një shteti federativ midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, duke evidencuar dy arsye kryesore: 1- Jugosllavia, tashmë, ishte e ngarkuar rëndë me një numër të konsiderueshëm minoritetesh dhe forca e tyre centrifugale në rritje, që nga viti 1919, po e çonte këtë vend drejt një dekompozimi të brendshëm. 2- Armiqësia e vjetër racore sllavo-shqiptare. Ndërsa bashkimin politik të Shqipërisë me Greqinë e quante “të natyrshëm” dhe “të goditur” për këto arsye:

Ai do të siguronte një zgjidhje rrënjësore të sigurimit strategjik të Greqisë në kufijtë e saj veri-perëndimorë dhe përkundrejt Italisë. Këtë përfitim diplomacia greke e konsideronte si më të rëndësishmin, përderisa, sipas saj, Lufta II Botërore kishte demonstruar rëndësinë jetike të këtij rreziku për Greqinë.

- Kjo zgjidhje, gjithashtu, do t'i shtonte potencialit të rezistencës greke dhe balancës politike të forcës në raport me shtetet sllave në Ballkan një element të shquar, i cili do ta bënte kryeurën ose pikëmbrojtjen greke shumë më të fuqishme, deri në infinit. Duke pretenduar se politika e demokracive perëndimore do të përfitonte me të vërtetë nga përforcimi i kryeurës greke në skajin jugor të Ballkanit e në hyrje të detit Adriatik dhe detit Egje, Pippinelis konkludonte se nuk mund të kishte mënyrë më të mirë për ta arritur këtë përforcim sesa duke përfshirë gjithë territorin e Shqipërisë në kuadrin e mbrojtjes së Greqisë.

- Bashkimi i Shqipërisë me Greqinë, paraqitej si komplementar dhe i dobishëm edhe nga pikëpamja ekonomike. Sipas planit të Pippinelisit, popullsia e qyteteve greke, të cilat kishin arritur në një pikë ngopjeje, do të gjente një dalje ose një shkarkim interesant në Shqipëri, e cila ishte kryesisht një vend bujqësor dhe blegtoral, që i mungonte pikërisht një popullsi e zhvilluar urbane. Blegtoria dhe ekonomia bujqësore e Shqipërisë, të cilën, çuditërisht, diplomati grek e konsideronte të zhvilluar, do të gjente në territorin grek, deficitar në blegtori dhe në produkte bujqësore, tregje relativisht të mira. Në të vërtetë, ky argument nuk ishte real. Natyra e ekonomisë së Shqipërisë dhe e Greqisë ishte e përafërt, ku bujqësia dhe blegtoria zinin peshën kryesore dhe këto tregje nuk mund të tërhiqnin njëri-tjetrin. Greqia e viteve '40 nuk kishte një urbanizim të tillë, i cili do ta shndërronte atë në një metropol për Shqipërinë. Me të drejtë, Pippinelis pohonte se Korça dhe Gjirokastra, të cilat dikur kishin qënë lidhur administrativisht dhe ekonomikisht respektivisht me Selanikun dhe Janinën dhe që ishin dëmtuar dukshëm ekonomikisht qëkurse ishin ndërprerë lidhjet midis tyre, do të rifitonin prosperitetin e mëparshëm ekonomik si qendra të prodhimit e konsumit lokal. Por ky përfitim mund të realizohej edhe në një rrugë tjetër,

kur të dy vendet të njihnin sovranitetin dhe integritetin territorial të njëri-tjetrit, të përmirësonin marrëdhëniet politike, të liberalizonin e të nxisnin marrëdhëniet ekonomike dhe posaçërisht tregtinë në zonat kufitare.

- Pippinelis vinte në dukje se bashkimi i Shqipërisë me Greqinë do t'i jepte përgjigje problemit të sigurimit të Shqipërisë nga pikëpamja ballkanike, sepse prapavija e saj do të mbulohej dhe pozita e saj do të forcohej, si ndaj Italisë, ashtu edhe ndaj Jugosllavisë. Në të vërtetë, ky argument mund të ishte real dhe i vlefshëm, në qoftë se atë do ta kishte afirmuar e kaluara e marrëdhënieve shqiptaro-greke. Disa politikanë shqiptarë, që më parë kishin këmbëngulur për një bashkim të tillë politik greko-shqiptar, e kishin pasur parasysh këtë avantazh. Por ofertat e tyre ishin hedhur poshtë vazhdimisht nga shteti grek dhe, për më tepër, për fatin e keq të shqiptarëve, përvoja nuk krijonte asnjë shkëndijë besimi e shprese për një bashkëjetesë politike me kombin dhe shtetin grek. Arsyet më kryesore ishin pengesat që u kishin nxjerrë shteti dhe kisha greke përpjekjeve të shqiptarëve për çlirimin kombëtar, arsimit në gjuhën shqipe, afirmimit të identitetit të tyre kombëtar, pavarësisë dhe, mbi të gjitha, synimet e vazhdueshme të Greqisë për aneksimin e trojeve shqiptare. Masakrat greke të viteve 1914-1915 në Shqipërinë e Jugut dhe ato më të freskëtat, që ishin kryer në vitet 1944-1945 kundër popullsisë shqiptare të Çamërisë, të cilat kishin përfunduar me spastrimin e dhunshëm etnik të saj, nuk linin asnjë shpresë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi. Vetëm përmbysja e kësaj politike mund ta sillte një rezultat të tillë. Por edhe memorandum i Pippinelisit, nuk linte shpresa se politika greke ndaj Shqipërisë, të paktën në një të ardhme të afërt, do të ndryshonte në drejtimin e duhur pozitiv.

Pippinelis në memorandumin e tij parashtronte në vija të përgjithshme edhe tiparet që do të kishte shteti i ri federativ greko-shqiptar. Ai afirmonte si parim themelor të ndërtimit të këtij shteti, sigurimin e vetëqeverisjes lokale dhe të vetëvendosjes për të dy popujt, lirinë absolute në drejtimin e çështjeve të brendshme të të dy vendeve nëpërmjet institucioneve të tyre demokratike, e cila do të sigurohej plotësisht me drejtimin e përbashkët të çështjeve ekonomike, ushtarake dhe diplomatike. Ai shprehte bindjen se lehtësisht mund të gjendej një formulë ligjore për këtë bashkim politik, duke marrë si model monarkinë dualiste Austro-Hungareze, ose Perandorinë Britanike, ose duke u bazuar në zhvillimin konstitucional të Federatës Zvicerane. Në të vërtetë, hipernacionalizmi i theksuar në Greqi, urrëjtja patologjike, që ishte kultivuar nga politika dhe propaganda greke kundër shqiptarëve për dekada të tëra, mungesa e besimit reciprok midis dy popujve dhe diferencat e thella në zhvillimin ekonomik, shoqëror e shpirtëror nuk mund të lejonin zbatimin e planit të Pippinelisit. Për këto arsye, parashikimet e tij për një pozitë të barabartë dhe marrëdhënie të hapura midis dy kombeve, dukeshin qartë se ishin thjesht një hipokrizi politike.

Diplomati grek ishte përpjekur t'i vinte planit të tij edhe një bazë historike. Ai pohonte se ideja e këtij "kooperimi" midis popullit shqiptar dhe atij grek në një unitet politik i kishte rrënjët e thella dhe se historia e këtyre dy popujve dhe, në shumë drejtime, afiniteti i tyre racial e kishte hapur vetë rrugën për një zgjidhje të tillë të çështjes shqiptare. Ai sillte si argumente në këtë drejtim, marrëveshjen e parë midis kapedanëve grekë dhe shqiptarë, në Sul, më 15 janar 1821, për të formuar një aleancë, dhe zotimin që i kishin dhënë njëri-tjetrit se "do të ishin vëllezër të bashkuar në një trup dhe në një shpirt"; propozimin që gjoja i kishin bërë shqiptarët qeverisë greke më 2 qershor 1829, për përfshirjen e krahinës së Vlorës në shtetin grek, me kusht që atyre t'u garantohej liria e besimit fetar dhe të ruhej nderi i haremeve të tyre; memorandumun e një "numri të madh" të shqiptarëve, nën udhëheqjen e Gjolekës, dërguar Mbretit të Greqisë, Otto, për bashkimin e Shqipërisë me Greqinë; memorandumun dërguar Lordit Beaconsfield nga Komiteti Shqiptar gjatë zhvillimit të Kongresit të Berlinit, në të cilin sugjerohej sërish ideja e bashkimit greko-shqiptar dhe pohohej se "fuqia jonë mbrojtëse mund të dyfishohet në një Federatë dhe nëpërmjet një aleance me Greqinë".

Pippinelis përpiquej t'i vinte idesë së tij të Konfederatës shqiptaro-greke edhe një mbështetje historike nga ana e opinionit grek. Ai i referohej Shoqërisë Greko-Shqiptare të Athinës, e cila në vitin 1899 kishte propozuar "bashkimin e të dyja racave sipas modelit të Austro-Hungarisë". Si një shembull tjetër ai përmendte traktativat e Ismail Qemalit në vitet 1904, 1906 dhe marrëveshjen e tij me kryeministrin grek George Theotoki më 1908, për çlirimin e Shqipërisë dhe bashkimin e saj me Greqinë. Duke dashur të krijonte imazhin e vazhdimësisë dhe të konservimit të kësaj "dëshire të hershme" të shqiptarëve, Pippinelis përmendte edhe një propozim të ish-kryeministrit të Shqipërisë, Koço Kota, në shkurt të vitit 1944, bërë guvernatorit ushtarak të Selanikut, për bashkimin e grekëve dhe të shqiptarëve me këto kushte: të respektohej dinjteti shqiptar; të ruheshin kufijtë e vitit 1940; të dy shtetet të formonin një monarki dualiste, të kishin një administratë të përbashkët për punët e jashtme, një shtab të përbashkët ushtarak, dogana dhe shërbim postar të përbashkët, me përjashtim të Ministrive të Arsimit, Financave dhe Drejtësisë. Parimin për ruajtjen e kufijve të vitit 1940, domethënë aneksimin e Shqipërisë së Jugut, pas krijimit të Federatës greko-shqiptare, Pippinelis e quante të pranueshëm, pasi ai do të zgjidhte "çështjen më të ngatërruar të marrëdhënieve greko-shqiptare, problemin e "Vorio-Epirit". Madje, sipas tij, bashkimi i Shqipërisë me Greqinë "do të jepte automatikisht zgjidhjen më të mirë të kësaj çështjeje" për arsye se kufijtë, ushtria, ekonomia dhe politika e jashtme e përbashkët, lëvizja e lirë e qytetarëve të të dy shteteve dhe një marrëveshje e kënaqshme, e bazuar në parimin e vetëqeverimit lokal, do të ofronte mundësi të reja në këtë drejtim. Zgjidhjen e çështjes së "Vorio-Epirit" sipas këtij projekti, Pippinelis e

konsideronte një përfitim të madh, pasi, sipas tij, do të eliminohej njëri nga burimet më të rrezikshme të grindjeve në marrëdhëniet greko-shqiptare.

Plani Pippinelis ishte një manovër e re e diplomacisë greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut nëpërmjet krijimit të një shteti konfederativ shqiptaro-grek. Karakterin e vërtetë antishqiptar të planit Pippinelis e zbulonin konsideratat politike, ekonomike, gjeopolitike etj., të cilat, sipas tij, e bënë të domosdoshme zhdukjen e Shqipërisë nga harta e Ballkanit. Ashtu si e gjithë politika dhe historiografia greke, ai e konsideronte eksperiencën e kaluar historike të shtetit shqiptar një “eksperiment të dhimbshëm” dhe pikërisht mbi bazën e këtij koncepti ai projektonte të konstruktonte edhe të ardhmen e Shqipërisë. Duke iu referuar eksperiencës së të kaluarës, si një udhëheqëse për qëndrimin ndaj çështjes shqiptare, ai theksonte se që nga viti 1913, kur Shqipëria ishte themeluar si një “hegjemoni autonome”, dhe deri në vitin 1939, kur ajo ra nën pushtimin italian, shteti shqiptar kishte qenë nën tutelën e shteteve të huaja, të cilat e kishin bërë pavarësinë e Shqipërisë një “nacion teorik”. Ai e konsideronte pushtimin e Shqipërisë nga Italia si një pasojë e varësisë ekonomike dhe politike të Shqipërisë prej saj. Në këtë rast, ai shtrembëronte shkaqet e vërteta të invazionit italian të Shqipërisë, i cili nuk u shkaktua nga marrëdhëniet italo-shqiptare të paraluftës, por ishte fillimi i realizimit të politikës ekspansioniste të Italisë në Ballkan. Pippinelis përpiqej t’i mbështeste argumentet e veta edhe në gjendjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave gjatë viteve 1944-1948 dhe të marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike. Ai shkruante se pas Luftës II Botërore “indipendencja e Shqipërisë ra nën kontrollin e Jugosllavisë së Titos”, dhe, pas konfliktit midis Informbyrosë dhe Titos dhe, pas konfliktit midis Informbyrosë dhe Titos, ajo ra krejtësisht nën varësinë e Moskës. Por edhe këto konstatime kategorike nuk ishin të sakta. Shqipëria nuk e humbi pavarësinë e saj as në vitet 1945-1948 as më vonë. Dominimi i udhëheqjes së PKJ mbi udhëheqjen komuniste shqiptare ishte koniunktural dhe në kundërshtim me vullnetin e popullit shqiptar. Qeveria komuniste në atë kohë, si të gjitha regjimet komuniste të Europës Lindore, nuk përfaqësonte vullnetin e shumicës së popullit shqiptar. Për këtë arsye marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të kësaj kohe, mund të konsiderohen vetëm si një aksident në zhvillimin politik të shtetit shqiptar dhe jo si një ligjësi historike. Edhe varësia e Shqipërisë nga B.Sovjetik kishte afërsisht po këtë karakter. Në këto pozita qëndronin edhe shtetet e tjera të Evropës Lindore, varësia e të cilave nga B.Sovjetik nuk është vlerësuar nga askush si një defekt i pavarësisë së tyre, e aq më pak si një defekt gjenetik, siç e cilësonte Pippinelis varësinë e udhëheqjes shqiptare nga ajo sovjetike.

Pippinelis nuk gjykonte me tendenciozitet vetëm të shkuarën e Shqipërisë, por parashikonte edhe të ardhmen e saj. Ai parashikonte se, pas vendosjes së një regjimi të ri postkomunist, udhëheqësit e rinj shqiptarë do të kërkonin një “gardian të ri të fqinjët”. Pra, ai e paraqiste shtetin e pavarur shqiptar, jo vetëm

një eksperiment të dështuar të së shkuarës, por edhe si një realitet politik që s'kishte të ardhme. Ai përpiqej ta argumentonte këtë tezë me faktorët ekonomikë dhe etnikë. Në memorandumin e lartpërmendur ai shkruante se pavarësia e Shqipërisë nuk vuante vetëm nga lakmia e Italisë dhe e Jugosllavisë (Greqinë ai e përjashtonte, sigurisht qëllimisht dhe pa të drejtë), ose vetëm nga mungesa e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, por ajo vuante nga arsye më themelore, që kishin të bënin me “gjendjen ekonomike të këtij vendi, me diferencat raciale midis popujve të tij dhe, pjesërisht, me mungesën e një klase sunduese të aftë që të frymëzojë popullin shqiptar, të ndjekë një politikë të vendosur për të mbrojtur pavarësinë e tij”. Mungesën e komunikacioneve, të metodave ekonomike të përparuara dhe të personelit teknik; nevojën e domosdoshme për një ndihmë ekonomike bujare, e cila edhe në qoftë se do të jepej nga një shtet fqinj, do të përmbante kushte që do të çonin në varësinë politike dhe ekonomike të Shqipërisë, pamundësinë e investimeve kapitale në një shkallë të gjerë, për arsye të vështirësive në kthimin e tyre prej mundësive të kufizuara të prodhimit dhe konsumit, të pasigurisë politike dhe nga mungesa e punëve të përshtatshme e bizneseve të specializuara, Pippinelis i vlerësonte si faktorë të tjerë themelorë dhe të përhershëm, që e bënin të pamundur zhvillimin e pavarur ekonomik të Shqipërisë. Kështu, ai arrinte në përfundimin se ishte e natyrshme që rindërtimi ekonomik i Shqipërisë do të merrej përsipër ekskluzivisht nga shtetet fqinje, të cilat përpiqeshin të siguronin avantazhe politike dhe strategjike dhe kishin vullnetin që, si kompensim, të ngarkoheshin me një ekonomi të pasigurt dhe të mbulonin deficitet e përhershme të Shqipërisë. Pippinelis, në mënyrë tendencioze, përpiqej të bindte qeverinë amerikane për të miratuar propozimin e tij për zhdukjen e shtetit shqiptar nga harta e Ballkanit, duke i zmadhuar dhe duke i paraqitur si të përhershme e gjenetike vështirësitë fillestare të ndërtimit të ekonomisë dhe shtetit shqiptar. Faktet dhe argumentet, që janë në kundërshtim me tezat e Pippinelisit dhe përgjithësisht me politikën dhe historiografinë greke, të cilat e vinin theksin në defektet gjenetike të pavarësisë së Shqipërisë, janë të shumta, por më duket se shtjellimi dhe paraqitja e detajuar e tyre janë jashtë detyrës së këtij studimi.

Pas orvajtjeve për të shpjeguar pamundësinë e ekzistencës së një shteti të pavarur shqiptar, Pippinelis hidhej në kapitullin e rreziqeve, që përbënte rënia e këtij shteti në varësinë e një shteti tjetër, për fqinjët dhe për politikën e Fuqive të Mëdha Perëndimore. Ai, duke i injoruar zhvillimet e kohës në Europë, vinte në dukje se rënia e Shqipërisë nën varësinë italiane do ta ekspozonte Greqinë ndaj rrezikut imediat të një invazioni ushtarak, i cili do ta ndante territorin e Greqisë në dy pjesë dhe do ta vendoste Fushën e Thesalisë, që ishte një qendër prodhimi jetike për Greqinë, nën kontrollin e pushtuesve. Ai e vlerësonte Shqipërinë si një rrezik edhe për Jugosllavinë, si një kryeurë që përbënte një kërcënim vdekjeprurës për Maqedoninë dhe më tej për Jugosllavinë Jugore, ku vetëm një korridor prej 150 km ndante inkursionet e mundshme politike dhe

ushtarake nga Sofja dhe Tirana. Madje, sipas tij, ky kërcënim për Jugosllavinë ishte edhe më ogurzi, për arsye se në territorin e saj jetonte një minoritet shqiptar goxha i madh, i cili kufizohej me Shqipërinë. Karakterin e pazgjidhur të marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë dhe me Greqinë, Pippinelis e vlerësonte si një faktor që e komplikonte edhe më tej pozitën e shtetit shqiptar në Ballkan. Popullsinë shqiptare në Jugosllavi e vlerësonte si një rrezik për këtë shtet dhe nënvizonte përpjekjet që bënte e do të bënte Beogradi për të neutralizuar rreziqet që vinin nga fakti se Shqipëria shpejt ose vonë do të varej nga një fuqi e huaj dhe, më së shumti, nga Italia. Ai e ekzagjeronte rrezikun e varësisë së Shqipërisë nga Rusia, duke e cilësuar imediat dhe të madh për fqinjët, por edhe më gjerë. Shqipërinë e cilësonte si një kryeurë detare ruse në Adriatik dhe Mesdhe dhe nuk e quante një parashikim të guximshëm që lufta e ardhshme do të evidenconte rëndësinë e kësaj kryeure. Ai shkonte shumë larg dhe e paraqiste Shqipërinë si rrezik edhe për Italinë, Francën dhe Evropën Perëndimore, për rrugët e komunikacionit në Adriatik, që shkonin në drejtim të Jugosllavisë dhe Evropës Qendrore, dhe për rrugët e komunikacionit në Mesdheun Lindor.

Zëvendësministri i Jashtëm grek, në gjithë tjerren e tij të gjatë diplomatike, cekte drejtpërsëdrejti edhe çështjen për të cilën ai e kishte ndërmarrë këtë aksion, ëndrrën e vjetër greke të Megalidesë, - aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Ai theksonte se çështja e “Epirit të Veriut” kishte krijuar një hendek të pakapërcyeshëm midis dy popujve. Grekët e konsideronin këtë krahinë si tokë të vjetër greke, e cila ishte qeverisur me kohë prej tyre, por që nga periudha e sundimit të Ali Pashës, ishte dehelenizuar gradualisht, nëpërmjet persekutimit, shkombëtarizimit dhe shtypjes së të gjitha llojeve. Si të gjitha çështjet politike në Ballkan, çështja e “Epirit të Veriut” kishte rrënjë të thella dhe ndjenja fundamentale në popullin grek. Por, ndonëse përsëriste këtë “atu” të propagandës greke, Pippinelis, ndryshe nga shumë politikanë të tjerë grekë, nuk i shmangej tërësisht realitetit politik. Ai pranonte se katër dekadat e fundit, në çështjen e “Epirit të Veriut” kishte dhe një palë tjetër të interesuar, se “Epiri i Veriut” përbënte Shqipërinë e Jugut dhe aneksimi i saj nga Greqia do të konsiderohej prej shqiptarëve si një pushtim i tokës së tyre. Por këtë argument Pippinelis përpiqej ta vinte në funksion të propozimit të tij për bashkimin e Shqipërisë me Greqinë. Indirekt ai atakonte pikëpamjen e Departamentit të Shtetit se, pas përmbysjes së regjimit komunist, qeveria demokratike e Shqipërisë do të mund të ndërtonte marrëdhënie miqësore me Greqinë. Ai pohonte se edhe pas përmbysjes së komunizmit, fshehtas ose hapur, marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë dhe Jugosllavinë do të mbeteshin jomiqësore. Sipas tij, Shqipëria, e privuar nga bazat ekonomike dhe politike, do të ishte e shtrënguar t’i drejtohej një fuqie të huaj. Kështu, tensioni aktual në Ballkan nuk do të ulej dhe do të vazhdonte të ekzistonte një burim grindjesh dhe rreziku.